REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1091/20
Datë/Datum. 14.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-20-3281-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektimi i objekteve per nevojat e Komunes se Prishtines**

## ANKESË

**1. Identifikimi i ankuesit***

**VLERA SH.P.K**
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**12 Qershori,Shtime**
*(Adresa)*

**Shtime** — ***72000***
*(Vendi)* — *(Kodi postar)*

**044-287-776**
*(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

**Mufail Salihaj**
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**vlera.shpk@gmail.com**
*(Adresa elektronike)*

Dezinfektim-Dezinsektim-Deratizim PEST CONTROL & HYGIENE VLERA SH.P.K. SHTIME

***12.12.2020***
*(Data e parashtrimit të ankesës)* — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me* <u>*PROKURË.*</u>

*Shëno të dhënat si në vijim:*

___

*(Emri i avokatit)*

___

*(Adresa e plotë)*

___

*(Numri i Telefonit)*

___

*(Numri i faks-it)*

___

*(Adresa elektronike)*

___

*(Data e parashtrimit të ankesës)*

___

*(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

**1.Me daten 01.07.2020 eshte publikuar njoftimi per kontrate.**
**2.Formulari B54 me date:21.09.2020**
**3.Afati i fundit i dorezimit te ofertave, deri me 05.10.2020**
**4.Hapja e ofertave po te njejten date: 05.10.2020**
***5.B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit 02.11.2020 6.Leter Sqarimi Vlera Sh.P.K 05.11.2020***
***7.Vendimi i AK : 26.11.2020***
***8. Kërkesë për rishqyrtim 30.11.2020***
***9. Vendimi pas kerkeses per rishqyrtim03.12.2020***

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

| |
|---|
| |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

*Po* [X] *Jo* [ ]

***6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve***

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

| |
|---|
| |

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

| |
|---|
| Neni 1: Qellimi<br>Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti<br>Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi<br>Neni 59: Egzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve. Neni 69: Aftesia teknike dhe profesionale.<br>Neni 60: Kriteret per dhenje te kontrates.<br>Neni 66 : Përshtatshmëria Profesionale |

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Me datë **26.11.2020** kemi pranuar permes platformes E-prokurimi Njoftimin mbi vendimin e AK , ku komisioni i vleresimit na ka eleminuar per keto arsyeje:
1."*OE nuk sjellur deshmit qe paisjet tona kane sperkatje 5-50 mikron dhe 5-30 mikron*"
2. "*OE nuk ka sjellur deshmi per 5 pompa motorike LV*".
3. "*OE ka sjellur vetem nje ISO certifikate,mirpo nuk ka ofruar deshmit e kerkuara nga AK Certifikaten e analizave dhe MSDS te produktit qe do te perdoret*".

Pas leximit te arsyjeve per eleminim konstatuam qe komisioni i vleresimit as qe i ka shfletuar dokumentet tona duke na diskriminuar me apo pa qellim. Perpos mos perfilljes se Ligjit per Prokurim Publik ne kete Vendim dyshohet se ka shkelje te renda edhe te vepres penale nga AK respektivisht nga komisioni i vleresimit.

Me datë **02.11.2020** kemi pranuar *B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit* ku na eshte kerkuar sqarimi i shumices prej pikave te tenderit ,deshmit per 5 pompa LV , specifikacioni i paisjeve per mikronat si dhe MSDS. Me date **05.11.2020** kemi dorezuar "Leter Sqarimin" per pikat e kerkuara edhe pse njeherit AK i ka pasur te gjitha keto ne dosjen qe e kemi dorezuar ne fillim.

Per piken e larte cekur si pika 1 : *OE nuk ka sjellur deshmit qe paisjet tona kane sperkatje 5-50 mikron dhe 5-30 mikron*"
Ne ne dosjen tone te tenderit tek Lista e Paisjeve kemi dorezuar faturat per paisjet e larte cekura, fatura ***nr.113*** kurse ne leter sqarimin e kerkuar nga AK kemi bashkangjitur edhe specifikat qe paisjet tona kane sperkatje 5-50 mikron dhe 5-30 mikron.

Per piken 2 : "*OE nuk ka sjellur deshmi per 5 pompa LV*".
Deshmit per 5 pompa motorike LV i gjeni tek Lista e Paisjeve ,fatura 401102 nga Agromarket
kodi i Produktit 38107 ( Sperkatese Motorike DM ) ,gjithashtu te bashkangjitur jane edhe fotografit e produktit.

Per piken 3 : *OE ka sjellur vetem nje ISO certifikate,mirpo nuk ka ofruar deshmit e kerkuara nga AK Certifikaten e analizave dhe MSDS te produktit qe do te perdoret":* Deshmit i gjeni tek
"12.ATESTET,ANALIZAT.MSDS,CERTIFICATAT."
Ne kemi ofruar te gjithe dokumentacionin e kerkuar, duke filluar nga Atestet, certifikatat e analizave ,Msds te produktit qe do te perdoren si dhe 2 certifikatat e ISO standardeve te produkteve qe do te perdoren. (ashtu siq jane kerkuara ne dosje te tenderit )

Ne si profesionist te kesaj lamie me pervoje shume vjeqare ne kete fushe dhe me ekspert adekuat te kesaj fushe duke filluar nga Doktor shkence ne fushen e Mjedisit , Epidemiolog, Dr.Veterinar,Teknik Sanitar etj jemi bindur qe komisionet e vleresimit as qe jane ne dijeni se qka jane dokumentet e kerkuara.
Ne kemi bashkangjitur secelin prej tyre veq e veq dhe i kemi ndare ne ate menyre qe te kuptohen sa me lehte nga komisioni i vleresimit, por nga pergjigjja e dhene verehet as dokumentet tona as qe jane egzaminuar.
Janë absurde arsyet e eleminimit sepse kemi ofruar te gjitha dokumentet e kerkuara ku specifikohet qe aparatura ka sperkatje 5-50 mikron dhe ku dihet qe pompat elektrike ULV kane sperkatje 5-50 mikron.( "mikronat" jane madhesia matese e grimcave qe dalin nga aparati i ULV.)

Ne me daten 30.11.2020 kemi bere Kërkesë për rishqyrtim ne AK dhe me date 03.12.2020 kemi marrur vendimin per refuzim ne ankeses per arsyet e ngjajshme :
"paisjet nuk jane sipas specifikave te kerkuara nga AK "

Pastaj per pretendimin 2 per msds ak ka dhene pergjigje si me posht :
Dokumenti i msds dhe certifikata e analizave te preparatit eshte i sakt,mirpo preparati i paraqitur nga ju nuk i ploteson kerkesat e aneksit 1,pasi qe nuk eshte ne perberjen e kerkuar".

Ne Aneksin 1 te Dosjes se tenderit jane percaktuar se me cfare preparati te dezinfektohet dhe te bashkangjiten dokumentet e tij si me posht:

## *Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME*

*Përbërja aktive e dezinfekuesve:*

- *3,35g Didecyldimethylammoniumchlorid, 3,35g Quaternary ammonium, benzyl-C12-C16-alkyldimethylchlorid, 3,3g Quaternary ammonium, C12-14-Alkyl [(ethylphenyl) methyl] dimethyl-, Chloride, Isopropanol.*
- *Ose,*
- *3.33 g Didecyldimethylammoniumchloride, 6.66 g alkyl (C12-16) dimethylbenzylammoniumchlorid.*
- *3.4 g Didecyldimethylammonium chloride, 3.4 Quaternary aminioum compound benzyl-C12-C16- alkyldimethylchlorid, 3.2 Quaternary aminioum compound benzyl-C12-C14 Alkyl[(ethylphenyl)methyl]dimethyl-, Chloride, Alcool.*
- *Hydrogen Peroxide 38.5% Peroxyacetic Acid 14% Octanoic Acid 5.3%*
- *Hydrogen Peroxide 3.30% Didecyldimethyl ammonium carbonate 2.0-4.0% Didecyldimethyl ammonium bicarbonate 1.38%*
- *Hydrogen peroxide, 22.0% Peroxyacetic acid,15.0%*

- *Peroxyacetic Acid ,15% Hydrogen Peroxide,10%*

*VRËJTJE: OE duhet të cekë cilin dezinfektantues do të përdorë dhe për atë dezinfektantues duhet që të sjellë dokumentacionin percjelles si ne vijim:*

  - *Certifikatën e analizave*
  - *MSDS*
  - *Prodhuesi duhet të jetë me ISO certifikatë*

*Menyra e dezinfektimit sipas nevojave dhe kërkesës nga autoriteti kontratktues 24/7 . Afati i kryerjes se shërbimeve eshte 2 dite nga dita e pranimit te urdherit ng personi i autorizuar i AK-es.*

***Ne si Kompani kishim vendosur qe te perdornim keto produktet :***

- ***Peroxyacetic Acid ,15% Hydrogen Peroxide,10%***

***Produktete keto te paraqitura ne aneksin 1 .***

Ne i kishim bashkangjitur te gjitha dokumentet e nevojshme te produktit , MSDS, CERTIFIKATEN E ANALIZAVE, dhe CERTIFIKATEN E ISO STANDARDEVE TE KOMPANISE.

AK ne vendimin e fundit te dates 03.12.2020 thote qe produktet qe jane paraqitur nga ne, nuk ploteson kerkesat e kerkuara ne aneksin 1 .( ME larte kam cekur kerkesat e aneksit 1, ku eshte i njejti produkt i kerkuara nga ana e AK dhe te njejtat dokumente te kerkuara nga ata,msds, certifikaten e analizave,dhe iso standardeve )

AK nuk ka mundur qe te gjeje asnje arsye te vertete per te na eleminuar dhe nga panjohurit e tyre per dokumentet e produktit nxerrin si vendim qe produktet tona nuk plotesojn kerkesat e aneksit 1 .

Ak ne kete procedur te prokurumit ka vepruara kundrejt nenin 1 ,6,7,59,60 te LPPK-së duke na trajtuar si te pabarabarte me tenderuesin tjeter qe eshte rekomanduar per kontrat duke na diskriminuar dhe duke mos i vleresuar drejt dokumentet tona.

Njeherit AK ka rekomanduar tenderuesin me cmimin me te larte duke mos vepruar drejt dhe ne harmoni me Nenin 60, ku si kriter i dhenjes se kontrates ka qene : Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet .

*Gjate shoshitjes se Dokumentacionit te Kompanise se rekomanduar per kontrat perveq qe eshte shume me i shtrenjte se Kompania jone , kjo kompani nuk ka arritur qe ti plotesoj shumicen e kerkesave qe jane kerkuar nga AK. (te gjitha te cekura me poshte )*

**-----**

Me datë *27.11.2020* kemi marrur Dokumentacionin e Kompanisë se rekomanduar per kontrat
**DDD.SH.P.K.** permes usb,
dhe kemi hasur ne shume leshime me apo te pa qellimta qe i ka bere komisioni i vleresimit.
Perpos qe kjo kompani ka ofruar cmim shume me te shtrejte se kompania jone ata do te duhet te shpalleshin te pa pergjegjshem per keto arsyeje :

1. Kompania ne fjale DDD.SH.P.K. nuk posedon Certifikaten e Analizave te Produktit , vetem MSDS-në.
2. Kompania ne fjale ka ofruar vetem nje Pomp elektrike ULV elektrostatike 5-50 micron permes fatures *nr.19-SHV01-001-1682* kurse paisjet tjera jane Nebulizator dhe Pompa ULV qe vendosen ne veture per Dezinsektim Hapsinor qe fare nuk jane kerkuara ne dosje.
3. Kompania ne fjale ka ofruar 2 certifikata te kompanise te Iso standardeve te kerkuara ne dosje , por per asnjeren nga ato nuk kemi gjetur qe egzistojn ose qe jane valide, praktikisht kjo kompani ka ofruara Dokumente fallco sepse ne web-faqen e shkruar ne certifikate per te vertetuar validitetin e tyre dhe egzistencen e tyre del qe kompania DDD.SH.P.K nuk i posedon kete certifikate.

Per secilen certifikate te Iso standardeve mund qe te vertetohen ne internet egzistenca e tyre permes linqeve qe i ofron kompania e cila e ka leshuar certifikaten.

Linqet:
http://www.qeccert.com/ClientRpt1.aspx https://qec-malaysia.com/certificate-validation/

Permeses ketyre linqeve te Kompanise kompanise qe leshon ISO standardet nuk figuron qe kjo kompania eshte e paijsur me certifiakata ISO.
Ju ftojm qe te njejtin verifikim ta beni edhe ju. ( permes emrit te Operatarit dhe numrit te Certifikates.
Ne po ju bashkangjesim linqet ku edhe ju si Organ Shqyrtues i prokurimit mund ti vertetoni dhe te bindeni qe keto certifikate jane fallco . Gjithashtu po ju bashkangjese edhe deshmit per kete pike.

***Figura 1. Deshmia***




***Figura 2. Deshmia***




4.Kontratat qe kjo kompani ka bere me OE –tjere ne kete rast me Truly Nolen jane te pa noterizuara, praktikisht te pavlefshme.

Kerkojm nga Organi shqyrtues i prokurimit perkatesisht paneli shqyrtues dhe nga Ekspertet Shqyrtues profesionist qe te marrin :

**Vendim**

**Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "Vlera Sh.P.K"**
**Anulohet Vendimi i AK per dhenjen e Kontrates.**

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**1. Shkeljet e supozuara kane shkaktuar demtim te imazhit te kompanise tone, kur merret parasysh afarizmi shumevjeqar i kompanis sone ne kete lemi. Gjthëashtu na eshte shkaktuar dem marial-financiar. Shpenzimet arrijn vleren e 15,000.00 euro**

**2. Humbja e vendeve te punes per disa punetor qe per momentin jane te angazhuar dhe do ta shtonim numrin e puntorve ne rast qe kjo kontrate do te ishte nenshkruar**

**3. Humbja e tregut per punet qe do t'i ofrojme ne rast qe do ishim shpalle fitues**

**10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë*
*h) 1.Kërkesë për rishqyrtim AK PRISHTINE 30.11.2020*
*i) 2.B05 Njoftim per Kontrat 30.06.2020*
*j) 3.Procesverbali i hapjes 05.10.2020*
*k) 4.VENDIMI I AK 26.11.2020*
*l) 5.Vendimi pas kerkeses per rishqyrtim Vlera*
*m) 6.Paisjet VLERA SHPK*
*n) 7.ATESTET,ANALIZAT.MSDS,CERTIFICATAT VLERA SHPK*
*o) 8.ISO CERTIFICATE NSHP DDD te pa vertetuar (fiktive)*

*p) 9. Dokumentet ,Paisjet Teknike DDD shpk te rekomanduar per kontrat*
*q) 10.Dokumenti MSDS, DDD shpk te rekomanduar per kontrat*
*r) 11. Paisjet Teknike DDD shpk, te rekomanduar per kontrat*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*